



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 408/1 prot.

Tiranë, më 12.03.2021

**VENDIM**  
**Nr.28, datë 12.03.2021**

**PËR**  
**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË**  
**VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 29, DATË 27.02.2020**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr.29, datë 27.02.2020, të Komisionerit, “Mbi verifikimin e ligjshmërisë së marrëdhënies së punësimit të punonjësës së Bashkisë Lezhë, \*\*\*\*\*”.

**KONSTATOVA SE:**

Me anën e kërkesës së regjistruar me nr. 8 prot., datë 7.1.2020, punonjësja \*\*\*\*\* e cila mbante pozicionin si, “Specialist” në Sektorin e Transportit dhe Infrastrukturës, Drejtoria e Shërbimeve Publike, pranë Bashkisë Lezhë, ka ngritur pretendimin se konkluzioni i nxjerrë nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në vendimin paralajmëruar nr. 203, datë 9.10.2017, në përfundim të procesit të mbikëqyrjes në Bashkinë Lezhë, në lidhje me emërimin e saj në pozicionin e sipërpërmendur, është i kundërligjshëm. Sipas saj, edhe vendimi nr. 93, datë 15.10.2019, i Komisionerit, dalë në përfundim të inspektimit tematik për emërimet në kundërshtim me ligjin në këtë njësi të qeverisjes vendore, nuk është i drejtë.

Për verifikimin e informacionit, Komisioneri ka kryer hetimin administrativ të këtij rasti, duke kërkuar nga institucioni i Bashkisë Lezhë të dërgojë të gjithë dokumentacionin që disponon në lidhje me këtë rast.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 29, datë 27.02.2020, të Komisionerit, “Mbi verifikimin e ligjshmërisë së marrëdhënies së punësimit të punonjësës së Bashkisë Lezhë, \*\*\*\*\*”.

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Lezhë, ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues, duke bashkëngjitur dokumentacionin që provon zbatimin e tij.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr. 29, datë 27.02.2020, si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, të materializuara në dokumentet shkresore përkatëse, situata e administrimit të shërbimit civil në institucionin e mbikëqyrur paraqitet si më poshtë vijon:

Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse në Bashkinë Lezhë, për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë, të veprojë sipas masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit nr.93, datë 15.10.2019. Konkretisht, Komisioneri ka kërkuar:

- Të konstatohet pavlefshmëria absolute e aktit nr. 576, datë 01.11.2016, të nxjerrë nga Kryetari i Bashkisë, për emërimin e punonjës \*\*\*\*\* në pozicionin, “*Specialist*” i Transportit, Infrastrukturës dhe Mjedisit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës dhe Mjedisit.
- Të merren masat për plotësimin e pozicionit të sipërpërmendur sipas procedurave konkurruese të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e verifikimit, rezulton se, me shkresën nr. 20278 prot., datë 09.11.2020, njësia përgjegjëse e institucionit ka bërë shpalljen për pozicionin “*Specialist*” në Sektorin e Shërbimeve Publike, Transportit, Infrastrukturës dhe Mjedisit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës dhe Mjedisit pranë Bashkisë, kategoria III-b. Në përfundim të kësaj procedure njësia përgjegjëse ka shpallur fituese \*\*\*\*\* , duke e emëruar në pozicionin e mësipërm me aktin nr. 526 prot., datë 14.01.2021.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” dhe Rregulloren, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqytjen e Shërbimit Civil,

#### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 29, datë 27.02.2020, të Komisionerit, “*Mbi verifikimin e ligjshmërisë së marrdhënies së punësimit të punonjës së Bashkisë Lezhë, \*\*\*\*\**”.

2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Bashkia Lezhë, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr. 29, datë 27.02.2020.
3. Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Lezhë dhe nëpunësja \*\*\*\*\*.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**